



Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Predato Received / Delivered	31.05.2021	viti god year	1
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHACK	2745/2021		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.382/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca - kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1210/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrativ, ka shqyrtuar ankesën A.nr.50/2019 të datës 25.01.2019 të parashtruar nga grup ankuesish të cilët i përfaqëson ankuesi kundër Vendimit me numër protokoli 4150 të datës 27.12.2018 të Komisionit për Shqyrtimin e Shtesave në fushën e Teknologjisë Informative dhe Inxhinieringut pranë Ministrisë së Administratës Publike, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 31.05.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.50/2019 e datës 25.01.2019 e parashtruar nga grup ankuesish të cilët i përfaqëson ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesit, dhe të punësuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (me tutje KRPP), përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 25.01.2019 kanë parashtruar ankesë me numër protokoli 456/2019 të regjistruar me numër A.nr.50/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 4150 të datës 27.12.2018 të Komisionit për Shqyrtimin e Shtesave në fushën e Teknologjisë Informative dhe Inxhinieringut pranë Ministrisë së Administratës Publike, me pretendimin ankimor për realizimin e shtesës në pagë në vlerë prej 350 euro sipas titullit të punës Administrator dhe Programues.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 28.01.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të KRPP. Këshilli me datë 31.01.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 29.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1210/2019 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 12.03.2019 të parashtruar nga grup ankuesish të cilët me autorizim i përfaqëson ankuesi

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoli 456/2019 e regjistruar me numër A.nr.50/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoli 4150 të datës 27.12.2018 të Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Shtesat në Pagë në fushën e Teknologjisë Informative; Akt Emërimit e datës 04.05.2015 për H.G; Diplomën nr.1329 të datës 29.11.2013; Akt Emërimit e datës 04.05.2015 për D.B.B; Diplomën nr.1235 të datës 30.07.2013; Përshkrimin e detyrave të punës; Akt Emërimit e datës 04.05.2015 për V.I; Diplomën e datës 30.04.2014; Përshkrimin e detyrave të punës; Akt Emërimit e datës 01.08.2017 për E.SH; Diplomën e datës 08.07.2015; Përshkrimi i detyrave të punës; Përgjigje në ankesë të datës 31.01.2019, me numër protokoli 549/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa A.nr.50/2019 e datës 25.01.2019, **është e pa bazuar sepse:**

Bazuar në provat e lëndës është konstatuar se ankuesit janë të punësuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, dhe atë H.G në pozitën Administrator i Qendrës së të Dhënave të Rrjetit të Sigurisë; D.B në pozitën Administratore e Bazës së të Dhënave; V.I në pozitën Programues i Faqeve të Internetit; dhe E.SH në pozitën Administrator i TI-se për Bazë të të Dhënave.

Komisioni për Shqyrtimin e Shtesave në fushën e Teknologjisë Informative dhe Inxhinieringut, pranë ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me datë 27.12.2018, ka nxjerr Vendimin me numër protokoli 4150, përmes të cilit ka aprovuar kërkesën për shtesa në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë Informative dhe Inxhinieringut, duke iu njohur ankuesve të drejtën e realizimit të shtesës në shumën prej 200 Euro.

Të pakënaqur me Vendimin Nr.4150 të datës 27.12.2018 të Komisionit për Shqyrtimin e Shtesave, ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendim ankimor se shtesa e aprovuar në shumën prej 200 euro nuk është aprovuar konform pozitës së punës dhe të njëjtit pretendojnë realizimin e shtesës në shumën prej 350 euro sipas titullit të punës Administrator dhe Programues.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë Informative dhe Inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrencës për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumes stimuluese për postet e caktuara, se paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. *Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.07/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueseve për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analize që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston

vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.382/2021

Flakron Gashi

  
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve,
- Kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
- Udhëheqësit të Personelit në Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik;
- Arkivit të KPMSHCK-së

